

PRILL 2022

**Lufta Kundër Korrupsionit dhe Krimet
të Organizuar:**

**Roli i SPAK dhe Gjykatave të Posaçme
në drejtim të përmirësimit të
përgatitjes së vendit për antarësimin
në Bashkimin Evropian**

DOKUMENT POLITIKASH

QENDRA PËR STUDIMIN E DEMOKRACISË DHE QEVERISJES

Dokument Politikash

Lufta Kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar:

Roli i SPAK dhe Gjykatave të Posaçme në drejtim të
përmirësimit të përgatitjes së vendit për antarësimin
në Bashkimin Evropian

© Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG)

Tiranë, Prill 2022



Ky është dokumenti i dytë i politikave i përgatitur nga Qendra për Studimin e Demokracisë edhe Qeverisjes në kuadër të projektit:

“Përmirësimi i Debatit të Politikave dhe Llogaridhënies në Përbushjen e Grupit të Parë të Kapitujve Negociues (Cluster 1), përmes Krijimit të Platformës së Negociatave BE-Shqipëri për Cluster 1 (C1-EU-NPA)”

mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Tiranë

Opinionet, gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e shprehura në këtë dokument janë të autorit dhe nuk reflektojnë opinionet apo pikëpamjet e Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Tiranë.

Autorë:

Mirsada HALLUNAJ

Dizajni dhe faqosja:

Ergys TEMALI



Kingdom of the Netherlands

Përmbajtja

| | |
|---|-----------|
| Lista e Shkurtimeve..... | 5 |
| Përmbledhje Ekzekutive..... | 6 |
| PJESA I: Hyrje..... | 7 |
| Konteksti..... | 7 |
| Qëllimi i Dokumentit të Politikave..... | 8 |
| Metodologjia..... | 8 |
| Mbledhja e të Dhënave/Kufizime..... | 9 |
| PJESA II: Vlerësim i përmbushjes së prioriteteve në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar..... | 11 |
| Produktiviteti..... | 11 |
| Efiçenca..... | 15 |
| Ngritja e plotë e kapaciteteve të SPAK dhe Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar..... | 15 |
| Kohëzgjatja e çështjeve për korrupsion dhe krim të organizuar..... | 11 |
| Statistikat dhe track records..... | 17 |
| Sistemi i ri të Integruar për Menaxhimin e Çështjeve..... | 18 |
| Relevanca..... | 21 |
| Rastet e korrupsionit të nivelit të lartë..... | 21 |
| Hetimi dhe gjykimi i ish-magjistratëve të shkarkuar gjatë procesit të rivlerësimit (vetting-ut)..... | 22 |
| Rritja e sekuestrimeve/konfiskimeve të aseteve kriminale që rezultojnë nga vepra të lidhura me korrupsionin..... | 25 |
| Zhvillimet, tendencat dhe kërcënimet e krimit të organizuar..... | 28 |
| PJESA II: Rekomandime..... | 29 |
| Scorecard 1 - Çështje të Korrupsionit (të reja 2021 & stoku 2020)..... | 30 |
| Scorecard 2 - Çështje të Krimit të Organizuar (të reja 2021 stoku 2020)..... | 32 |
| Aneks 1..... | 34 |
| Aneks 2..... | 35 |

Lista e Shkurtimeve

| | |
|----------|--|
| BE | Bashkimi Evropian |
| BKH | Byroja Kombëtare e Hetimit |
| CEPEJ | Metodologjia e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë |
| GJKKO | Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar |
| ICMS | Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Çështjeve |
| KE | Komisioni Evropian |
| KPA | Kolegji i Posaçëm i Apelimit |
| KPK | Komisioni i Pavarur i Kualifikimit |
| KLGG | Këshilli i Lartë Gjyqësor |
| KLP | Këshilli i Lartë i Prokurorisë |
| MONEYVAL | Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit |
| OFL | Operacioni “Forca e Ligjit” |
| SPAK | Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar |

Përmbledhje Ekzekutive

Intensifikimi i luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar mbetet prioriteti kryesor i Bashkimit Evropian për Shqipërinë pas hapjes së negociatave të anëtarësimit në mars 2020 dhe Koferencës së Parë Ndërqeveritare.

Sipas metodologjisë së rishikuar të zgjerimit, lufta efektive kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar do të mbetet një nga treguesit kryesorë për përparimin në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, prandaj suksesi në sistemin e konsoliduar të të dhënave do të duhet të jetë i matshëm.

Në këtë kontekst, që nga ngritja e tyre në dhjetor 2019, veprimtaria e institucioneve të posaçme (SPAK dhe Gjykatat) ka qenë në fokus të monitorimit dhe vlerësimeve përkundërt progresit të Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si kushtet kryesore për anëtarësimin e vendit në Bashkimin Evropian.

Monitorimi sistematik dhe i vazhdueshëm i veprimtarisë së këtyre institucioneve kontribuon jo vetëm për të vlerësuar performancën e tyre dhe siguruar transparencën dhe informimin e nevojshëm, por edhe për të identifikuar mangësi dhe çështje të tjera relevante në funksion të përmirësimit të politikave në këtë drejtim si dhe adresimit të masave të tjera të nevojshme.

Që kjo e fundit të adresohet në mënyrë të saktë dhe koherente, nevojitet që institucionet kryesore përgjegjëse për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar të ndërtojnë një qasje të konsoliduar në drejtim të analizës së performancës dhe raportimit të tyre në lidhje me përmbushjen e objektivave strategjike si edhe rekomandimeve në kuadër të procesit të integritetit evropian të Shqipërisë.

Nga analiza dhe vlerësimi i bërë në këtë dokument politikash përkundërt një sërë indikatorësh sipas çështjeve të korrupsionit dhe krimit të organizuar, evidentohet nevoja për të përmirësuar më tej koordinimin ndërinstitutional në drejtim të metodologjisë për mbledhjen e të dhënave respektive si edhe mënyrën e raportimit dhe prezantimit të tyre.

Gjithashtu është e nevojshme që të mbledhen dhe zhvillohen në mënyrë të standardizuar të dhëna dhe statistika në lidhje me elementë ekonomike (burimet financiare, dëmin ekonomik dhe ndikimin në ekonominë e ligjshme), të cilat ndikojnë në vendimet e politikave dhe masa të tjera, si dhe të publikohen në funksion të rritjes së transparencës dhe përdorimit për qëllime të ndryshme.

Gjithashtu zhvillimi i metodave për mbledhjen sistematike të analizave dhe përdorimin e të dhënave ndihmon për të kuptuar më mirë peshën e çështjeve të korrupsionit dhe krimit të organizuar si edhe ndikuar në rritjen e njohurive të zbatimit të ligjit.

Kryerja e vlerësimeve sistematike, gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në një metodologji të mirëpërcaktuar, në mënyrë që të bëhet e mundur dhe të reflektohen objektiva dhe tregues konkretë, përbën një element thelbësor për të vlerësuar efektivitetin e masave të ndërmarra në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

PJESA I: Hyrje

1.1. Konteksti

Në 25 mars të vitit 2020 Këshilli i Bashkimit Evropian vendosi për hapjen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë.¹ Këshilli theksoi se para konferencës së parë ndërqeveritare, Shqipëria duhet ndër të tjera të finalizojë **ngritjen e strukturave të specializuara kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar**, ku përfshihen Prokuroria dhe Gjykatat e Posaçme si dhe të **intensifikojë më tej luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar**.²

Pak më shumë se 2 vjet nga ky proces, institucionet e reja të drejtësisë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Prokuroria dhe Gjykatat e Posaçme të cilat u krijuan në 19 dhjetor 2019, kanë hyrë tashmë në vitin e tretë të veprimtarisë së tyre, duke qenë në fokus kryesor për të vlerësuar efektivitetin e Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Krijimi i SPAK dhe Gjykatave të Posaçme, si një nga objektivat kryesorë të reformës në sistemin e drejtësisë dhe për më tepër nevoja për të adresuar një **përgjigje efektive kundrejt fenomeneve më problematike të shoqërisë shqiptare si korrupsioni dhe krimi i organizuar**, krijuan në mënyrë të veçantë pritshmëri të larta të qytetarëve nga këto institucione.

Megjithëse gjykatat dhe prokuroritë në tërësi konsiderohen ende si institucionet më pak të besueshme dhe më shumë të korruptuara, Prokuroria dhe Gjykatat e Posaçme konsiderohen si institucionet më të besuara të drejtësisë në vend.³ Gjithashtu, këto institucione konsiderohen nga një përqindje e konsiderueshme e qytetarëve si institucionet më pak të korruptuara dhe më të pavarura nga ndikimi politik.⁴

Megjithatë, pavarësisht këtyre perceptimeve, **korupsioni dhe krimi i organizuar vazhdojnë të përbëjnë ende një shqetësim serioz për vendin**. Raporti i Komisionit Evropian i vitit 2021 thekson se në tërësi **korupsioni është mbizotërues në shumë fusha të jetës publike dhe biznesit duke vazhduar të jetë një problem serioz**.⁵

Një vlerësim i ngjashëm theksohet edhe në raportin vjetor të GRECO për vitin 2020, i cili thekson se **niveli i korrupsionit mbetet i lartë si në sektorin publik ashtu dhe atë privat**, ndërkohë që një raport mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve do të dorëzohet këtij organi deri në 30 prill 2022.⁶

¹ Këshilli i Bashkimit Evropian, 7002/20: <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-7002-2020-INIT/en/pdf>

² Po aty

³ Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, Barometri i Sigurisë në Ballkanin Perëndimor (BSBP), “Perceptimi publik ndaj institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë, si dhe çështjeve të korrupsionit në Shqipëri”: <http://csdgalbania.org/sq/wp-content/uploads/2022/01/Barometer-2021-Albania-1-SHQ.pdf>

⁴ Po aty

⁵ Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2021: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en

⁶ GRECO, Fifth Evaluation Round “Preventing corruption and promoting integrity in central governments (top executive functions) and law enforcement agencies”: <https://rm.coe.int/fifth-evaluation-round-preventing-corruption-and-promoting-integrity-i/1680a0923d>

1.2. Qëllimi i Dokumentit të Politikave

Sipas metodologjisë së rishikuar të zgjerimit, lufta efektive kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar do të mbetet një nga treguesit kryesorë për përparimin në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, prandaj **suksesi në sistemin e konsoliduar të të dhënave do të duhet të jetë i matshëm.**

Në këtë kontekst, për të vlerësuar efektivitetin e masave në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është i nevojshëm **përcaktimi i qasje monitorimi dhe analize të konsoliduar**, e cila duke matur rezultatet e arritura përkundërt objektivave, të mund të kontribuojë në rritjen e **mbështetjes së aktivitetit të organeve të hetimit dhe gjykimit** si edhe në tërësi përparimit të procesit të integritetit evropian të Shqipërisë.

Në këtë kontekst, ky dokument politikash ka si qëllim kryesor që nëpërmjet monitorimit sistematik dhe të vazhdueshëm të veprimtarisë së institucioneve të posaçme si dhe bazuar në metodologjinë e përcaktuar, të ndërmarrë nismën për të prezantuar një **vlerësim më të plotë dhe gjithëpërfshirës të efektivitetit të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar** si prioritetet kryesore për përgatitjen dhe përparimin e vendit në Bashkimin Evropian.

Në të njëjtë kohë qëllimi i këtij dokumenti është të kontribuojë në përmirësimin e **informimit dhe transparencës si dhe identifikimin e mangësive dhe çështjeve të tjera relevante në funksion të përmirësimit të politikave penale dhe adresimit të masave të tjera të nevojshme.**

Ndër të tjera, ky dokument politikash ka si qëllim:

1. Të **nxisë diskutime mbi gjetjet** në drejtim të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar si dhe **gjenerojë rekomandime të nevojshme.**
2. Të kontribuojë në diskutime në lidhje me **qasjen dhe mekanizmat për vlerësimin e performancës** së institucioneve kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.
3. Të **nxisë bashkëpunimin, ndërveprimin dhe përfshirjen e institucioneve** me qëllim përmirësimin e vlerësimit dhe menaxhimit të performancës.
4. Të **nxisë angazhimin e aktorëve vendas dhe ndërkombëtarë si edhe palëve të tjera të interesit** për të identifikuar dhe adresuar problematika dhe çështje me rëndësi.

1.3. Metodologjia

Metodologjia e përdorur për kryerjen e analizës është bazuar në një numër **indikatorësh të matshëm** në përputhje me specifikat dhe problematikat e çështjeve të korrupsionit dhe krimit të organizuar të hetuara dhe gjykuara nga Prokuroria dhe Gjykatat e Posaçme KKO. (Shiko Tabela 1)

Qëllimi i përcaktimit të këtyre indikatorëve është matja e tre dimensioneve kryesore të cilat përfshijnë: **(1) produktivitetin; (2) efiçencën; dhe (3) relevancën**, mbi bazën e të cilave është vlerësuar efektiviteti i përgjigjes ndaj fenomeneve të korrupsionit dhe krimit të organizuar në Shqipëri.

1. **Dimensioni i produktivitetit** është fokusuar në vlerësimin e numrit të rasteve të iniciuara në baza vjetore si dhe statusin e tyre aktual;
2. **Dimensioni i efikasitetit** është fokusuar në vlerësimin e kohëzgjatjes së çështjeve sipas kalendarit kohor të gjykatave dhe kohëzgjatjes mesatare të çështjes;
3. **Dimensioni i relevancës** është fokusuar në vlerësimin e çështjeve në përputhje me kompleksitetin dhe rëndësinë.

1.4. Mbledhja e të dhënave/Kufizimet në zbatimin e Metodologjisë

Mbledhja e të dhënave është realizuar nëpërmjet **grumbullimit të informacionit dhe të dhënave të publikuara nga institucionet respektive**: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) dhe Gjykatat e Posaçme të Shkallës së Parë dhe Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Gjithashtu, në këtë dokument politikash janë referuar edhe burime dytësore, në funksion të plotësimit të informacionit për të dhënat e referuara këtu.

Pas sistemimit dhe koordinimit të të dhënave të marra nga institucionet zyrtare, nëpërmjet faqeve zyrtare të internetit, është krijuar **bazë të dhënash** e detajuar me qëllim vlerësimin dhe analizimin e mëtejshëm të ecurisë së çështjeve penale për korrupsionin dhe krimin e organizuar, të cilat janë analizuar bazuar në metoda analitike sasiore dhe cilësore.

Bazuar në këtë monitorim hapat e ndjekur përfshijnë:

1. Mbledhjen e informacionit/të dhënave në lidhje me ecurinë e çështjeve;
2. Analizimin e të dhënave/çështjeve në përputhje me indikatorët e përcaktuar.

Gjatë hartimit të kësaj baze të dhënash janë marrë në konsideratë edhe mangësi të cilat lidhen me mungesën e informacionit/të dhënave të publikuara apo përditësimin e tyre, megjithë minimizimin e këtyre mangësive duke ju referuar vetëm organeve zyrtare apo informacioneve të bëra publike nga përfaqësues të këtyre institucioneve në platforma të ndryshme mediatike.

Analiza e kryer bazuar në metodologjinë më lart, ka patur në fokus gjithashtu të gjenerojë **gjetje dhe rekomandime**, të cilat të kontribuojnë në përmirësimin e vlerësimin dhe analizës së performancës së institucioneve përkundrejt efektivitetit të masave në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.

| Lloji i veprave penale | PRODUKTIVITETI | | | EFIÇENCA | | | | | RELEVANCA | |
|---|-------------------------|-------------------|------------------------|---------------------------------|----------|-----------|----------|----------|---|--|
| | Statusi i çështjeve | | | Kohëzgjatja e procesit gjyqësor | | | | | Statusi i subjekteve të akuzuar/dënuar | Niveli i pasojës që rezulton nga sjellja kriminale |
| Vepra penale të korrupsionit | Çështje të regjistruara | Çështje në proces | Çështje të përfunduara | < 1 muaj | 1-6 muaj | 7-12 muaj | 1-2 vjet | > 2 vjet | Funksionarë të lartë shtetërorë ose të zgjedhur vendorë | Vlera ekonomike (humbja) më shumë se 1 milion Euro |
| | | | | | | | | | Gjyqtarë, prokurorë dhe funksionarë të tjerë të drejtësisë | Vlera ekonomike (humbja) ndërmjet 400 mijë Euro dhe 1 milion Euro. |
| | | | | | | | | | Persona që ushtrojnë funksione publike/Të tjerë | Vlera ekonomike (humbja) ndërmjet 100 deri 400 mijë Euro |
| Vepra penale në fushën e krimit të organizuar | Çështje të regjistruara | Çështje në proces | Çështje të përfunduara | < 1 muaj | 1-6 muaj | 7-12 muaj | 1-2 vjet | > 2 vjet | Kompleksiteti i krimit | Niveli i pasojës që rezulton nga sjellja kriminale |
| | | | | | | | | | Veprat kryesore penale | Vlera e mallrave të ligjshëm dhe/ose të paligjshëm të përfshirë |
| | | | | | | | | | Numri i personave të përfshirë ⁷ | Veprimtaria/veprimet themelore kriminale të ndërmarra |
| | | | | | | | | | Zona gjeografike e veprimit (veprimtari transnacionale e krimit të organizuar) ⁸ | Mënyra e veprimit (modus operandi) të krimit të organizuar |

Tabela 1: Indikatorët e përdorur për të vlerësuar procedimet penale në fushën e korrupsionit dhe krimit të organizuar të regjistruara në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) dhe Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

⁷ - Numri i anëtarëve të grupit më shumë 10, i Lartë
- Numri i anëtarëve të grupit ndërmjet 5-10, Mesatar
- Numri i anëtarëve të grupit ndërmjet 3-5, i Ulët
⁸ Aktivitet, i cili përfshin Shqipërinë dhe 1 vend tjetër
- Aktivitet, i cili përfshin Shqipërinë dhe 2 vende të tjera
- Aktivitet, i cili përfshin Shqipërinë dhe më shumë se 2 vende të tjera


PJESA II: Vlerësim i përmbushjes së prioriteteve në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar

2.1. PRODUKTIVITETI

Numri i procedimeve penale të regjistruara në Prokurorinë e Posaçme KKKO përgjatë vitit 2021 ka pësuar një rritje krahasimisht me vitin 2020. Procedimet penale në fushën e korrupsionit përbëjnë numrin më të lartë të procedimeve të regjistruara, ndërkohë që evidentohet një numër i njëjtë i procedimeve për krim të organizuar të regjistruara gjatë dy viteteve të veprimtarisë së Prokurorisë së Posaçme KKKO.

Megjithëse deri në fund të vitit 2021 një numër i konsiderueshëm i procedimeve penale të regjistruara në Prokurorinë e Posaçme ka qenë në hetim, ashtu sikurse edhe gjatë vitit 2020, numri i procedimeve penale të dërguara për gjykim rezulton të jetë mjaft i ulët krahasimisht me numrin total të procedimeve penale të regjistruara.

Vetëm 33 nga 339 procedimeve për korrupsion (9.8%) janë dërguar për gjykim dhe vetëm 14 nga 164 procedime në fushën e krimit të organizuar (8.5%) janë dërguar për gjykim në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë KKO.




Grafik 1: Ecuria e Procedimeve penale të regjistruara në Prokurorinë e Posaçme

Burimi i të dhënave: Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK)

Megjithëse në raportin vjetor për vitin 2021 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar theksohet rëndësia e trajtimit në mënyrë efikase të rasteve specifike të korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimin të organizuar, të dhënat e prezantuara nuk pasqyrojnë një ndarje të qartë mbi numrin e saktë të rasteve për korrupsion dhe krim të organizuar.

Bazuar në mbledhjen e të dhënave për çështjet e publikuara në faqen zyrtare të kësaj gjykate, gjatë vitit 2021 janë regjistruar në total 48 çështje të lidhura me veprat penale të korrupsionit, 36 prej të cilave përfunduan gjatë vitit 2021. Stoku (backlog) i çështjeve penale të lidhura me korrupsionin në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë nga viti 2020 ka qenë 19 çështje dhe për vetëm 1 prej tyre ka vazhduar gjykimi gjatë vitit 2021, ndërkohë që ka përfunduar për 18 të tjerat.

Gjatë vitit 2021 Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka dhënë në total 54 vendime për çështje të korrupsionit, 36 prej të cilave për çështje të regjistruara gjatë vitit 2021, ndërkohë që 18 të tjera janë backlog nga viti 2020. Krahasimisht me vitin 2020 numri i çështjeve për krim të organizuar të regjistruara për gjykim në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë KKO është më i ulët përkundrejt çështjeve të korrupsionit.



Grafik 2: Ecuria e çështjeve penale të regjistruara në Gjykatë e Posaçme të Shkallës së Parë KKO

Burimi i të dhënave: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Përgjatë vitit 2021 në Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar u regjistruan në total 19 çështje të lidhura me veprat penale të krimin të organizuar, 5 prej të cilave përfunduan brenda vitit 2021. Stoku (backlog) i çështjeve penale të lidhura me krimin e organizuar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë ka qenë 34 çështje, për 18 prej të cilave gjatë vitit 2021 kjo Gjykatë ka përfunduar gjykimin.

Gjatë vitit 2021 Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka dhënë në total **23 vendime për çështje të krimit të organizuar**, 5 prej të cilave janë regjistruar gjatë vitit 2021, ndërkohë që 18 të tjera janë backlog nga viti 2020.

Krahasimisht me vitin 2020, evidnetohet një numër më i lartë çëshjesh, të cilat përfshijnë vepra të tjera penale, kryesisht të lidhura me akuzat penale për shpifje të parashikuara në nenet 120/1 dhe 120/2 të Kodit Penal.

| Prokuroria e Posaçme KKKO | | | Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë KKO | | | | | | | | | |
|---------------------------|--------------------------------|------------------------------|--|---------------------------------|--------------------------|-----------|------------------------------|--------------------------|-----------|-----------------------------------|--------------------------|-----------|
| Viti 2021 | Nr. total i procedimeve penale | Procedime dërguar për gjykim | Viti 2021 | Çështje të regjistruara në 2021 | Përfunduar në vitin 2021 | Në gjykim | Çështje të mbartura nga 2020 | Përfunduar në vitin 2021 | Në gjykim | Totali i çështjeve për vitin 2021 | Përfunduar në vitin 2021 | Në gjykim |
| Korrupsion | 339 | 33 | Korrupsion | 48 | 36 | 12 | 19 | 18 | 1 | 67 | 54 | 13 |
| Krim i organizuar | 164 | 14 | Krim i organizuar | 19 | 5 | 14 | 34 | 18 | 16 | 53 | 23 | 30 |
| Të tjera | 172 | 1 | Të tjera | 26 | 14 | 12 | 2 | 2 | 0 | 28 | 16 | 12 |
| Totali | 675 | 48 | Totali | 93 | 55 | 38 | 55 | 38 | 17 | 148 | 93 | 55 |
| Viti 2020 | Nr. total i procedimeve penale | Procedime dërguar për gjykim | Viti 2020 | Çështje të regjistruara në 2020 | Përfunduar në vitin 2020 | Në gjykim | Çështje të mbartura nga 2019 | Përfunduar në vitin 2020 | Në gjykim | Totali i çështjeve për vitin 2020 | Përfunduar në vitin 2020 | Në gjykim |
| Korrupsion | 238 | 50 | Korrupsion | 38 | 20 | 19 | 2 | 2 | 0 | 40 | 22 | 19 |
| Krim i organizuar | 164 | 16 | Krim i organizuar | 27 | 2 | 25 | 23 | 14 | 9 | 50 | 16 | 34 |
| Të tjera | 162 | 4 | Të tjera | 4 | 2 | 2 | 1 | 1 | 0 | 5 | 3 | 2 |
| Totali | 564 | 70 | Totali | 70 | 24 | 46 | 26 | 17 | 9 | 96 | 41 | 55 |

Tabela 2: Ecuria e çështjeve për korrupsion dhe krim të organizuar

Burimi i të dhënave: Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) & Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

2.2. EFIÇENCA

Kohëzgjatja e proceseve gjyqësore konsiderohet një element i rëndësishëm në administrimin efektiv të sistemit gjyqësor dhe për rrjedhojë edhe rritjen e efektivitetit në trajtimin e rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Megjithatë duke marrë në konsideratë faktin që institucionet e posaçme janë përballur me një volum punë të shtuar edhe përgjatë vitit 2021, ndërkohë që kanë funksionuar me kapacitete jo të plota njerëzore, ky seksion fokusohet dhe në evidentimin e çështjeve të cilat ndikojnë në nivelin e efikasitetit të trajtimit dhe zgjidhjes së rasteve për korrupsion dhe krim të organizuar.

2.2.1. Ngritja e plotë e kapaciteteve të SPAK dhe Gjykatave të Posaçme KKO

Megjithëse ngritja dhe funksionimi i institucioneve të reja të drejtësisë ishte një ndër hapat më të rëndësishëm të reformës në sistemin e drejtësisë, ende Prokuroria dhe Gjykatat e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar nuk funksionojnë me kapacitet të plotë.

Për këtë arsye, **ngritja dhe forcimi i kapaciteteve**⁹ duke përfshirën rekrutimin me prioritet të stafit teknik dhe burimeve të nevojshme njerëzore të specializuara dhe mirëtrajnuara kanë qenë disa nga rekomandimet e adresuara në vazhdimësi.¹⁰

Më shumë se 2 vjet nga ngritja dhe funksionimi i Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ky institucion **funksionon aktualisht me 17 prokurorë**, pas përzgjedhjes së 2 prokurorëve të fundit nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë në 13 dhjetor 2021.¹¹

Buxheti i vitit 2021 parashikoi një rritje të numrit të prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar duke e çuar atë në **20 prokurorë**,¹² megjithatë ky numër ende nuk është plotësuar.

Gjatë fillimit të veprimtarisë, Prokuroria e Posaçme ka hasur në **mangësi edhe sa i përket plotësisë me staf administrativ** si pasojë e procedurave tepër teknike dhe

⁹ Këshilli i Bashkimit Evropian, 7002/20: <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-7002-2020-INIT/en/pdf>

¹⁰ GRECO, Fifth Evaluation Round “Preventing corruption and promoting integrity in central governments (top executive functions) and law enforcement agencies”: <https://rm.coe.int/fifth-evaluation-round-preventing-corruption-and-promoting-integrity-i/1680a0923d>

¹¹ Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Vendim Nr. 387, datë 13.12.2021 “Për emërimin si prokuror në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”: <https://klp.al/wp-content/uploads/2021/12/Vendim-Nr.-387-dt.-13.12.2021.pdf>

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Vendim Nr. 388, datë 13.12.2021 “Për emërimin si prokuror në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”: <https://klp.al/wp-content/uploads/2021/12/Vendim-Nr.-388-dt.-13.12.2021.pdf>

¹² Kuvendi i Shqipërisë, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Projektvendim “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme”, 20.01.2021: https://www.parlament.al/Files/Projekte/20210126121828Raport_prvendimi%20per%20miratimin%20e%20numrit%20te%20pergjithshem%20te%20prokuroreve%20ne%20SPAK.pdf

të detajuara ligjore për rekrutim, duke qenë një nga institucionet e reja të drejtësisë me nivelin më të ulët të shpenzimeve të buxhetit për vitin 2020.¹³

Ngritja dhe funksionimi i Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH), një strukturë e specializuar në mbështetjen e veprimtarisë së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, ka vijuar edhe përgjatë vitit 2021, megjithëse procesi i përgjedhjes së 60 hetuesve i filluar në janar 2020¹⁴ ende nuk është përmbyllur.

Në prill 2021, Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës mbylli verifikimin e kushteve të sigurisë për kandidatët aplikantë dhe vendosi për plotësimin e kushteve të sigurisë për **28 prej tyre**, të cilët përpara certifikimit i nënshtrohen një trajnimit 3 mujor,¹⁵ ndërkohë që BKH vijon procesin e përzgjedhjes së **32 hetuesve të tjerë** i hapur në 6 prill 2021.¹⁶ Ngritja e BKH është një proces që ndiqet nga një Komision Ndërkombëtar i përbërë nga ekspertë të caktuar nga Bashkimi Evropian dhe qeveria e Shteteve të Bashkuara.

Nga ana tjetër, plotësimi i vendeve vakante në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar vazhdon të jetë një **nga sfidat dhe kufizimet kryesore** për mbarvajtjen sa më efikente të këtyre institucioneve, të cilat në të dyja shkallët përbëhen aktualisht nga një numër i ulët gjyqtarësh të emëruar përkundrejt numrit të parashikuar në dispozitat ligjore (**7 gjyqtarë në shkallën e parë¹⁷ nga 16 dhe 7 gjyqtarë¹⁸ në apel nga 11**).¹⁹

Duke filluar që në shkurt të vitit 2020 KLGJ pa vijuar me procedurat respektive ligjore për plotësimin e vendeve vakante në Gjykatat e Posaçme e të dyja shkallëve, por mungesa e aplikimeve dhe procesi i rivlerësimit kalimtar ka sjellë që ky proces të mos sjellë rezultat e dëshiruara.²⁰ Përveç mungesës së gjyqtarëve, organet e posaçme të gjykimit rezultojnë të kenë **mungesa edhe në drejtim të stafit administrativ**.

Gjatë vitit 2020, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar funksionoi me një **organikë të reduktuar prej 63%**, dhe Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar funksionoi me rreth **49% të gjyqtarëve dhe me rreth 66% të stafit mbështetës**.²¹ Plotësimi sa më i shpejtë i vendeve vakante me gjyqtarë në organikën e Gjykatës së Shkallës së Parë, me

¹³ Instituti për Zhvillim dhe Bashkëpunim, “Good governance of new justice institutions in Albania”, November 2021: <https://cdinstitute.eu/wp-content/uploads/2021/11/Good-governance-of-New-Justice-Institutions-in-Albania.pdf>

¹⁴ Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH), Të reja: <https://bkh.al/category/news/>

¹⁵ Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH), Njoftim: <https://bkh.al/2021/04/01/njoftim-10/>

¹⁶ Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH), Njoftim: <https://bkh.al/2021/04/06/njoftim-per-shpallje-konkursi-per-hetues-ne-byrone-kombetare-te-hetimit/>

¹⁷ Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Analiza Vjetore e Punës 2021: https://www.gjpk.gov.al/rc/doc/Analiza_vjetore_2021_GJKKO_4774.pdf

¹⁸ Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Programi i Transparencës: <http://www.gjykata.gov.al/gjykata-e-posacme-e-apelit-per-korrupsionin-dhe-krimin-e-organizuar/gjykata-e-posacme-e-apelit-per-korrupsionin-dhe-krimin-e-organizuar/programi-i-transparences/programi-i-transparenc%C3%ABs/>

¹⁹ Ligj 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”

²⁰ Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), Njoftim për shpalljen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatat e Posaçme: <http://klgj.al/njoftim-per-shpalljen-e-procedures-se-ngritjes-ne-detyre-ne-gjykatat-e-posacme/>


²¹ Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), Raport mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2020: <http://klgj.al/wp-content/uploads/2021/06/Raporti-Vjetor-KLGJ-2020.pdf>

qëllim shpërndarjen e ngarkesës së konsiderueshme të çështjeve gjyqësore të gjyqtarëve, mbetet një nga prioritetet e këtij institucioni edhe për vitin 2022.²²

Megjithë përpjekjet e bëra në këtë drejtim nga organet qeverisëse të sistemit gjyqësor dhe atij të prokurorisë, siç janë KLGJ dhe KLP, mangësitë e lartpërmendura përbëjnë një problematikë prezente në drejtim të funksionimit sa më eficient të këtyre institucioneve. Adresimi i këtyre çështjeve mbetet prioritar duke patur parasysh edhe rekomandimet që lidhen me forcimin e hetimit, ndjekjes penale dhe gjykimin e çështjeve komplekse të korrupsionit dhe krimit të organizuar.²³

2.2.2. Kohëzgjatja e çështjeve për korrupsion dhe krim të organizuar

Raporti vjetor për vitin 2021 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë KKKO, paraqet një vlerësim të përgjithshëm në lidhje me kohëzgjatjen e çështjeve penale të themelit, duke mos bërë një ndarje të kohëzgjatjes së çështjeve për korrupsion dhe krim të organizuar. E njëjta gjë evidentohet edhe në raportin vjetor të KLGJ për vitin 2020. Grafiku më poshtë synon të japë një vlerësim të kohëzgjatjes së çështjeve bazuar në të dhënat e mbledhura, duke i kategorizuar sipas llojit të çështjeve. Në mungesë të numrit të plotë gjyqtarëve dhe volumit të çështjeve të trajtuara, kohëzgjatja e proceseve gjyqësore është një faktor kryesor në përcaktimin e efektivitetit të sistemit gjyqësor.



Grafik 3: Kohëzgjatja e çështjeve për korrupsion dhe krim të organizuar

Burimi i të dhënave: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

²² Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Analiza Vjetore e Punës 2021: https://www.gjp.gov.al/rc/doc/Analiza_vjetore_2021_GJKKO_4774.pdf

²³ Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2021: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en

2.2.3. Statistikat dhe track records

Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor janë organet kryesore për menaxhimin e sistemit të prokurorisë dhe atij gjyqësor, duke patur në këtë mënyrë edhe një rol të rëndësishëm në monitorimin e veprimtarisë së Prokurorisë dhe Gjykatave të Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, të cilat raportojnë mbi veprimtarinë e tyre.²⁴

Një element i rëndësishëm në këtë drejtim janë edhe statistikat dhe të dhënat, të cilat shërbejnë ndër të tjera për matjen dhe vlerësimin e menaxhimit dhe performancës së këtyre institucioneve.²⁵

Në këtë kontekst, megjithë masat e ndërmarra²⁶ si edhe raportimet periodike,²⁷ zhvillimi i një historiku rezultatesh (track records) përbën një nga rekomandimet më të rëndësishme të Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë të vitit 2021, i cili e konsideron atë një objektivi që kërkon vullnet politik dhe veprime të mëtejshme të strukturura dhe të qëndrueshme.²⁸

Përveç vijimit të luftës kundër korrupsionit, raporti thekson nevojën për krijimin e një baze të dhënash solide të hetimeve, ndjekjes penale dhe gjykimit të çështjeve të korrupsionit, sekuestrimit dhe konfiskimit/rikuperimit të aseteve kriminale të cilat rezultojnë nga kryerja e veprave penale të korrupsionit. Në mënyrë të veçantë theksohet zhvillimi i një baze të dhënash për çështjet në të cilat janë përfshirë nivele të larta.

Raporti rekomandon gjithashtu përmirësimin e mëtejshëm të metodologjisë për mbledhjen e të dhënave për çështjet e korrupsionit dhe krimit të organizuar, ndërkohë që thekson krijimin e një sistemi të unifikuar për menaxhimin e çështjeve për hetimin, ndjekjen penale dhe dënimet. Sigurimi i një ndërveprimi efikas të punës së SPAK dhe BKH mbetet një nga elementët kryesorë për të minimizuar stokun e çështjeve sensistive/të niveleve të larta.

Edhe në luftën kundër krimit të organizuar, megjithëse raporti përmend përpjekjet e bëra në ndërtimin e një baze të dhënash mbi luftën kundër krimit të organizuar,

²⁴ Ligj 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”

Ligj 96/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”

²⁵ Forcimin e Eficencës dhe Cilësisë së Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri (SEJ III), Mbledhja e të Dhënave, Menaxhimi i Çështjeve dhe Strategjia e IT-së në Shqipëri, Beqiraj - Epineuse – Stawa, Mars 2020:

<https://rm.coe.int/report-court-statistics-al-mar2020-albanian-converted-1-al/16809ebf40>

²⁶ Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), Vendim Nr. 47, datë, 11.02.0221 Për miratimin e “Udhëzuesi “Për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe efikasitetit të gjykatave”: <http://klgj.al/wp-content/uploads/2021/03/VENDIM-Nr.-47-dat%C3%AB-11.02.2021-P%C3%8BR-MIRATIMIN-E-%E2%80%99CUDH%C3%8BZUESI-%E2%80%99CP%C3%8BR-MBAJTJEN-DHE-PLOT%C3%8BSIMIN-E-TABELAVE-ME-T%C3%8B-DH%C3%8BNA-STATISTIKORE-P%C3%8BR-EFEKT-T%C3%8B-MATJES-DHE-MONITORIMIT-T%C3%8B-PRODUKTIVITETIT-DHE-EFI%C3%87ENC%C3%8BS-S%C3%8B-GJYKATAVE%E2%80%9D%E2%80%9D.pdf>

<http://klgj.al/akte-normative-nenligjore/>

²⁷ Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Analiza Vjetore e Punës 2021: https://www.gip.gov.al/rc/doc/Analiza_vjetore_2021_GJKKO_4774.pdf

²⁸ Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2021: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en

rekomandon rritjen e mëtejshme të përdorimit sistematik të hetimeve financiare paralele në rastet e krimit të organizuar, trafikimit të paligjshëm, terrorizmit dhe pastrimit të parave, ndërkohë që duhet vazhduar ndërtimi i bazës së të dhënave për vendimet përfundimtare që lidhen me krimin e organizuar, korrupsionin, trafikimin dhe pastrimin e parave.

Krijimi i sistemit të unifikuar të mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të statistikave të kriminalitetit, bazuar në standardet ndërkombëtare ka qenë dhe një nga rekomandimet për vitin 2021 të Rezolutës së Kuvendit.²⁹

2.2.4. Sistemi i ri të Integruar për Menaxhimin e Çështjeve

Krijimi i një Sistemi të ri të Integruar për Menaxhimin e Çështjeve është një nga rekomandimet kryesore të Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë i vitit 2021.³⁰ Raporti evidenton disa mangësi që lidhen me funksionimin e sistemit aktual të menaxhimit të çështjeve dhe thekson se Shqipëria ka bërë progres të limituar në lidhje me rekomandimet e vitit 2020 për të përmirësuar sistemin e menaxhimit të çështjeve.

Raporti rekomandon që Shqipëria duhet të ndërmarrë në vitin që vjen hapa përcaktues për të krijuar një sistem të ri të integruar të menaxhimit të çështjeve dhe për të siguruar ndërveprimin e tij në të gjithë sistemin e drejtësisë në përputhje me metodologjinë e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) si dhe për të siguruar një funksionim efikas të SPAK dhe BKH si një kusht kryesor për të minimizuar backlog-un e çështjeve sensitive të niveleve të larta.

Në dhjetor 2021 Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi Udhërrëfyesin për zhvillimin e Sistemit të ri të Menaxhimit të Çështjeve,³¹ ndërkohë që në tetor 2021 u krijua Qendra e Teknologjisë së Informacionit e cila ka për mision caktimin e standardeve dhe politikave në përputhje me rregullat për politikën e përgjithshme shtetërore për sistemin e teknologjisë së informacionit dhe të dhënave (pajisje dhe programe), duke siguruar përmbushjen e nevojave të institucioneve të sistemit të drejtësisë.³²

Strukturat e specializuara kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, ku përfshihen Prokuroria dhe Gjykatat e Posaçme janë ndër palët kryesore të interesit dhe përdoruesit e ardhshëm të ICMS. Ngritja e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë përbën një hap pozitiv në drejtim të

²⁹ Kuvendi i Shqipërisë, Rezolutë për Vlerësimin e Veprimtarisë së Prokurorisë për Vitin 2020: <https://www.parlament.al/LibrariaAkteve/LibrariaAkteDetails/6465>

³⁰ Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2021: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en

³¹ Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), Njoftim për shtyp, datë 17 Dhjetor 2021: <http://klgj.al/njoftim-per-shtyp-date-17-12-2021/>

³² Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), Krijimi i Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë, 19 tetor 2021: <http://klgj.al/krijimi-i-qendres-se-teknologjise-seinformacionit-per-sistemin-e-drejtësisë/>

Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë: <https://qti.al/>

përbushjes së rekomandimeve të Komisionit si edhe objektivave specifike (2.4 dhe 4.1) të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025.³³

Nga ana tjetër, unifikimi i sistemeve për menaxhimin e çështjeve apo atyre elektronike mund të shërbejë për të hedhur hapa të tjerë përpara në drejtim të dixhitalizimit të procedurave gjyqësore, me qëllim rritjen dhe përshpejtimin e bashkëpunimit gjyqësor ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të Bashkimit Evropian duke eliminuar pengesat, dhe ndërmarrë reforma të rëndësishme në drejtim të drejtësisë elektronike.³⁴

³³ Vendim Nr. 823, datë 24.12.2021 Për Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021–2025, dhe të planit të saj të veprimit: https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/01/VKM-Nr.823-dat%C3%AB-24.12.2021-e-bashkuar_compressed.pdf

³⁴ Dorina Ndreka Asllanaj “Gjykatat elektronike si mjet për të përshpejtuar bashkëpunimin gjyqësor midis Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian”, Mars 2021: <https://www.eurospeak.al/news/dossier/gjykatat-elektronike-si-mjet-per-te-pershpejtuar-bashkepunimin-gjyqesor/>

2.3. RELEVANCA

Ky seksion ka si qëllim të vlerësojë të dhënat dhe rezultatet e institucioneve të posaçme përkundrejt objektivave strategjike që kanë këto institucione si edhe prioritetet dhe rekomandimeve kryesore në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.

2.3.1. Rastet e korrupsionit të nivelit të lartë

Hetimet dhe dënimet për raste të korrupsionit të nivelit të lartë, janë ndër rekomandimet kryesore pas ngritjes dhe funksionimit të Prokurorisë dhe Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë evidenton që ndjekja penale dhe numri i dënimit në çështjet e korrupsionit, të cilat përfshijnë zyrtarë të niveleve të larta mbeten të limituara duke konsideruar se kjo ka nxitur ende një kulturë të mosndëshkueshmërisë brenda niveleve të larta shtetërore.³⁵

Nga 67 çështje në total për korrupsion gjatë vitit 2021 në vetëm 4 prej tyre përfshihen si palë të akuzuara subjekte në kategorinë funksionare apo ish funksionare të nivelit të lartë dhe vetëm 1 çështje i referohet korrupsionit aktiv/pasi të gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë.

Të gjitha çështjet e tjera të korrupsionit në këtë gjykatë (62) përfshijë akuza për korrupsion përkundrejt subjekteve të tjera, pjesa më e madhe e të cilëve punonjës të cilët ushtrojnë funksione publike.

Veprat penale, të cilat lidhen me korrupsionin aktiv dhe pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike, përbëjnë numrin më të madh të akuzave penale në çështjet e korrupsionit në gjykim në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë, të ndjekura nga akuzat për shpërdorim detyre, shkelje të barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike si edhe ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike.

Gjatë vitit 2021 Prokuroria e Posaçme ka qenë gjithashtu objekt i disa ndryshimeve që lidhen me ushtrimin e kompetencave lëndore të këtij institucioni. Specifikisht në 23 mars 2021 Parlamenti i Shqipërisë³⁶ miratoi propozimet e paketës së përbërë nga 10 projektligje,³⁷ të cilat i referoheshin edhe ndryshime lëndore të Prokurorisë së Posaçme.

Ndryshimet e miratuara në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë parashikojnë limite të reja monetare për disa prej veprave penale të korrupsionit (244, 245/1, 258 dhe 259), duke sjellë që kur përfitimi i paligjshëm i përfituar nga ushtrimi i

³⁵ Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2021: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en

³⁶ Parlamenti i Shqipërisë, Çështjet (votimet e seancës plenare, datë 23 mars 2021): [https://www.parlament.al/Files/VotaDeputet/Si%20kane%20votuar%20deputetet%20\(Mars%202021\)-pjesa%20e%20kat%C3%ABrt.pdf](https://www.parlament.al/Files/VotaDeputet/Si%20kane%20votuar%20deputetet%20(Mars%202021)-pjesa%20e%20kat%C3%ABrt.pdf)

³⁷ Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, Raport Vlerësimi “Veprimtaria e Prokurorisë së Posaçme dhe Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar 2020”: http://csdgalbania.org/sq/wp-content/uploads/2021/03/Raport-Vleresimi_SPAK-Gjykatat-2020-FINAL-1.pdf

këtyre veprave është mbi 50.000 lek ato të jenë në kompetencë lëndore të Prokurorisë së Posaçme.³⁸ Ndryshime të tjera parashikojnë zgjerimin e kompetencave të SPAK në lidhje me të gjitha veprat e terrorizmit.³⁹

Nga ana tjetër, siç evidentohet edhe nga të dhënat, në të gjitha çështjet e gjykuara për korrupsion evidentohet përdorimi i tij në formë të rryshfetit, ndërkohë që në çështjet të cilat përfshijnë vepra penale që lidhen me shpërdorimin e detyrës dhe shkeljen e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike vlerat monetare të shkaktuara si pasojë e këtyre rasteve janë më të larta. Në vetëm një çështje dëmi ekonomik i shkaktuar shtetit ka qenë i konsiderueshëm, ndërkohë që në pjesën më të madhe të rasteve dëmi apo humjet ekonomike mbeten të ulta.

2.3.2. Hetimi dhe gjykimi i ish-magjistratëve të shkarkuar gjatë procesit të rivlerësimit (vetting-ut)

Procesi i rivlerësimit kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve, i cili filloi në mars 2018, solli shkarkimin e 111 gjyqtarëve dhe 66 prokurorëve,⁴⁰ ndërkohë që me zgjatjen e mandatit të tyre në shkurt 2022, institucionet e rivlerësimit do të vijojnë procesin edhe për 332 subjekte të tjera deri në fund të vitit 2024.⁴¹ Fillimi i hetimeve penale kundrejt ish-gjyqtarëve dhe prokurorëve të shkarkuar nga procesi i rivlerësimit (vetting-u), u përcaktua nga vendet anëtare të Këshillit Evropian si një nga kushtet kryesore që Shqipëria duhet të plotësojë përpara konferencës së parë ndërqeveritare.⁴²

Në prill të vitit 2020 në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar u paraqit një procedim penal kundrejt 20 ish-gjyqtarëve dhe ish-prokurorëve pranë gjykatave të shkallës së parë, apelit, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, si dhe prokurorive të ndryshme, për veprat penale të parashikuara nga nenet 143, 143/a/6, 180, 181, 248 dhe 257/a të Kodit Penal, të lidhura kryesisht me deklaratimet e kryera nga këta subjekte para Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe vendimet e shkarkimit të tyre nga KPK-ja.⁴³

Bazuar në kompetencat e Prokurorisë së Posaçme, për 10 ish-magjistratë çështja u dërgua në prokuroritë e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit,⁴⁴ ndërkohë që për 10

³⁸ Kuvendi i Shqipërisë, Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar:

<https://www.parlament.al/ProjektLigje/ProjektLigjeDetails/53570>

³⁹ Po aty

⁴⁰ City News Albania: <https://www.cna.al/2021/12/31/111-gjyqtare-dhe-63-prokurore-te-shkarkuar-ne-3-vite-vettingu-boshatis-drejtisine/>

⁴¹ Ligj nr. 16/2022 “Për një ndryshim në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

⁴² Këshilli i Bashkimit Evropian, 7002/20: <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-7002-2020-INIT/en/pdf>

⁴³ Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), Mbi kallëzimin penal kundër disa subjekteve ish-gjyqtar dhe ish-prokurorë të shkarkuar nga detyra nga Komisioni Pavarur i Kualifikimit: <https://spak.al/2020/05/08/mbi-kallezimin-penal-kunder-disa-subjekteve-ish-gjyqtar-dhe-ish-prokurore-te-shkarkuar-nga-detyra-nga-komisioni-pavarur-i-kualifikimit/>

⁴⁴ Shqiptarja.com: [https://shqiptarja.com/Ripostiglio/oggetti/202004/5eab1d9ec09d7kall-SPAKUT%20\(1\)-converted_001.pdf](https://shqiptarja.com/Ripostiglio/oggetti/202004/5eab1d9ec09d7kall-SPAKUT%20(1)-converted_001.pdf)

1. Fatmir Lushi (ish-prokuror në Prokurorinë e Elbasanit); 2. Luan Dervishi (ish-gjyqtar në Gjykatën e Apelit Shkodër); 3. Marina Rraboshta (ish-gjyqtare në Gjykatën e Apelit Shkodër); 4. Petrit Fusha (ish-drejtuës i

subjektet e tjera me funksion ish-gjyqtarë të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, në Prokurorinë e Posaçme u regjistrua procedimi penal Nr.137/2020, për veprën penale "Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publik ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim", të parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal.⁴⁵ Në vijim të këtij procedimi, policia gjyqësore referoi gjithashtu në Prokurorinë e Posaçme një kallzim penal edhe për ish-gjyqtarët Fatos Lulo, Admir Thanza dhe Xhezair Zaganjori të cilët janë trajtuar në kuadër të procedimit penal të mësipërm.

Për 3 prej ish-magjistratëve të shkarkuar, Prokuroria e Posaçme paraqiti në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, kërkesat përkatëse për sekuestrimin e pasurive në zotërim/pronësi të subjekteve dhe për të cilat Gjykata e Posaçme vendosi në prill 2021 për pranimin e kërkesës për vendosjen e sekuestros.⁴⁶

Vetë ish-Ministrja e Drejtësisë deklaroi në shtator 2020 në mbledhjen e Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian se në total kanë filluar procedimet penale ndaj 23 ish-magjistratëve, duke përfshirë 9 çështje në lidhje me gjyqtarët e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, të shkarkuar nga procesi i rivlerësimit.⁴⁷ (Shiko Tabela 2)

Në gusht 2021, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dërgoi për gjykim në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë KKO ish-Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese Bashkim Dedja dhe ish-gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese Fatos Lulo, pas përfundimit të hetimeve për mosdeklarim dhe fshehje pasurie.⁴⁸ Ish-magjistratët e shkarkuar nga procesi i rivlerësimit,⁴⁹ u akuzuan për kryerjen e veprës penale "Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim", kryer në formën e deklarimit të rreme dhe të fshehjes, të parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal.

Prokurorisë Tiranë); 5. Besnik Cani (ish-drejtues i Prokurorisë Elbasan); 6. Besim Trezhnjeva (ish-gjyqtar Gjykata e Apelit Durrës); 7. Arjan Balliu (ish-gjyqtar Gjykata e Apelit Durrës); 8. Ferdinand Elezi (ish-drejtues i Prokurorisë së Apelit Durrës); 9. Ema Gashi (Gjykata e Rrethit Durrës), 10. Besa Nikëhasani (ish-drejtuese e Prokurorisë Apelit Shkodër).

⁴⁵ Po aty: 1. Adriatik Llalla (ish-Prokuror i Përgjithshëm); 2. Bashkim Dedja (ish-Kryetar i Gjykatës Kushtetuese); 3. Tom Ndreca (ish-gjyqtar në Gjykatën e Lartë); 4. Shkëlzen Selimi (ish-gjyqtar në Gjykatën e Lartë); 5. Gani Dizdari (ish-gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese); 6. Artan Zeneli (ish-gjyqtar në Gjykatën e Lartë); 7. Edmond Islamaj (ish-gjyqtar në Gjykatën e Lartë); 8. Guxim Zenelaj (ish-gjyqtar në Gjykatën e Lartë); 9. Besnik Imeraj (ish-gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese); 10. Aleksandër Muskaj (ish-gjyqtar në Gjykatën e Lartë).

⁴⁶ Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), Njoftim për Shtyp:

<https://spak.al/2021/04/28/njoftim-per-shtyp/>

⁴⁷ Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian, Procesverbal 23.09.2020:

<https://www.parlament.al/Files/Integrimi/Precesverbal23.09.2020.pdf>

Projektplani Kombëtar për Integrimin Evropian 2021-2023: <https://drejtesia.gov.al/per-miratimin-e-planit-kombetar-per-integrimin-evropian-2021-2023/>

⁴⁸ A2News, Fshehën pasuritë, SPAK dërgon për gjykim Bashkim Dedjan dhe Fatos Lulon:

<https://a2news.com/video/fshehen-pasurite-spak-dergon-per-gjykim-bashkim-dedjan-dhe-fatos-lulon/>

⁴⁹ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK), Vendim Nr. 12, datë 23.03.2018: <https://kpk.al/wp-content/uploads/2017/11/KPK-Vendimi-Fatos-Lulo-23032018-Njoftuar-Anonimizuar.pdf>

Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA), Vendim Nr. 12, datë 17.12.2018: <http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/02/Vendimi-i-anonimizuar-subjekti-B.-Dedja.pdf>

Megjithatë, në tetor dhe nëntor 2021,⁵⁰ Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar riktheu kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për të dy ish gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, për të bërë plotësimin e hetimeve për këtë çështje.

Ndërkohë në fund të muajit dhjetorit 2021 Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, vendosi të pushojë procedimin penal për deklarim të rremë apo fshehje së pasurisë ndaj 5 ish-gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe 2 ish-gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të cilët u larguan nga sistemi i drejtësisë përmes vetting-ut (të gjithë për kriterin e pasurisë) apo dorëheqjeve.⁵¹

Specifikisht, Prokuroria e Posaçme në kërkesën e datës 30 dhjetor 2021 për pushimin e çështjes ndaj 7 ish-gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe asaj Kushtetuese ka specifikuar se në plotësimin e deklaratës vetting të pasurisë dhe deklaratave periodike vjetore për periudhën 2013-2016 mund të ketë patur pasaktësi, që klasifikohen si të natyrës administrative apo jo në përputhje me ligjin 84/2016, por që nuk përmbajnë elementë të veprës penale të parashikuar nga neni 257/2 i Kodit Penal në kuadër të deklaramit të rremë apo të fshehjes së pasurisë.⁵²

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë KKO ende nuk është shprehur në lidhje me vendimin e mësipërm në lidhje me pushimin e procedimit penal për 7 ish-gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe asaj të Lartë, megjithëse shkarkimi i 5 prej tyre nga vetting-u ka rezultuar si pasojë e problematikave të hasura në kriterin e pasurisë.

Aktualisht përveç shpalljes fajtor dhe dënimit të ish-Prokurorit të Përgjithshëm në shtator të vitit 2021,⁵³ konfiskimit të pasurive dhe përjashtimit për ushtrimin e funksioneve publike për një periudhë 5 vjeçare, nuk janë gjykuar dhe dënuar ish-magjistratë të shkarkuar gjatë procesit të rivlerësimit.

Nisja e hetimeve dhe gjykimi i ish-magjistratëve të shkarkuar nga procesi i rivlerësimit është një nga rekomandimet kryesore në drejtim të punës dhe arritjes së rezultateve të SPAK dhe Gjykatave të Posaçme. Ende dënimet për këto subjekte mbeten të ulta, ndërkohë që një rol të rëndësishëm pritet të luajnë edhe institucionet e rivlerësimit KPK dhe KPA nëpërmjet referimit të gjetjeve dhe pasaktësive të evidentuara gjatë procesit të rivlerësimit.⁵⁴

⁵⁰ Shqiptarja.com, GJKKO rikthen për hetim çështjen e Bashkim Dedjas, avokati: Vendim i drejtë, dosja e SPAK kishte mungesa për deklarimin e të ardhurave: <https://shqiptarja.com/lajm/gjkkko-rikthen-per-hetim-ceshtjen-e-bashkim-dedjas-avokati-vendim-i-drejte-dosja-e-spak-kishte-mungesa-per-deklarimin-e-te-ardhurave>

GJKKO kthen sërish për hetim çështjen e ish anëtarit të Kushtetueses Fatos Lulo, dosja duhet të plotësohet! Afati shtyhet për më 1 dhjetor: <https://shqiptarja.com/lajm/gjkkko-kthen-serish-ceshtjen-e-ish-anetarit-te-kushtetueses-fatos-lulo-dosja-duhet-te-plotesohet-afati-shtyhet-per-me-1-dhjetor>

⁵¹ Aleksandër Muskaj, Artan Zeneli, Besnik Imeraj, Edmond Islamaj, Gani Dizdari Tom Ndreca dhe Xhezair Zaganjori.

⁵² Gazeta Panorama, SPAK pushon hetimet për disa nga ish-anëtarët e Gjykatës së Lartë, të dyshuar për fshehje të pasurisë: <http://www.panorama.com.al/spak-pushon-hetimet-per-disa-nga-ish-anetaret-e-gjykates-se-larte-te-dyshuar-per-fshehje-te-pasurise/>

⁵³ Zëri i Amerikës, Tiranë, ish kryeprokurori Llalla dënohet me dy vjet burgim për korrupsion: <https://www.zeriamerikes.com/a/6240938.html>

⁵⁴ MCN TV, “Të larguarit e vetting-ut s’po hetohen nga SPAK”, Komiteti i Helsinkit: KPK dhe KPA nuk referojnë rastet: <http://www.mcntv.al/node/122657>

2.3.3. Rritja e sekuestrimeve/konfiskimeve të aseteve kriminale që rezultojnë nga vepra të lidhura me korrupsionin

Megjithëse Raporti i Komisionit Evropian i vitit 2021 thekson se Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) ka kontribuar në përmirësimin e sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve kriminale që lidhen me çështje të korrupsionit, ende vlerësohet se duhet të rriten përpjekjet dhe vullneti politik në drejtim të sekuestrimit dhe konfiskimit/rikuperimit të aseteve kriminale që rezultojnë nga veprat penale të lidhura me korrupsionin.⁵⁵

Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (MONEYVAL) një organ i përhershëm monitorues i Këshillit të Evropës, vlerëson se statistikën e disponueshme mbi numrin dhe vlerën e aseteve të sekuestruara dhe konfiskuara nuk rezultojnë të jenë në përpjestim me gjendjen e kriminalitetit në vend,⁵⁶ ndërkohë që një sfidë në këtë drejtim mbetet edhe konfiskimi i aseteve të sekuestruara.⁵⁷

Sekuestrimi dhe konfiskimi i aseteve kriminale të korrupsionit apo krimin të organizuar përbën një nga prioritetet e punës së Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Gjatë vitit 2021, Prokuroria e Posaçme përveç sekuestrimeve në kuadër të Ligjit Anti-mafia ka zbatuar edhe sekuestrimet/konfiskimit në proces penal të shoqëruara me dënime për pastrim parash.⁵⁸

Megjithatë dhe pavarësisht rritjes së vlerave nga viti 2020, siç evidentohet nga të dhënat e publikuara për vitet 2020 dhe 2021 nga Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, rezulton që vetëm rreth 15% aseteve të sekuestruara është konfiskuar, një përqindje mjaft e ulët krahasimisht me numrin total të pasurive të sekuestruara.⁵⁹

Numrin më të lartë e përbëjnë kërkesat për sekuestrim në kuadër të zbatimit të Aktit Normativ Nr. 1, datë 31.1.2020 "Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimin të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike",⁶⁰ megjithatë edhe numri dhe vlera e konfiskimeve

⁵⁵ Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2021: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en

⁵⁶ MONEYVAL, Anti-money laundering and counter-terrorist financing measures 2018 (Fifth Round Mutual Evaluation Report): <https://rm.coe.int/committee-of-experts-on-the-evaluation-of-anti-money-laundering-measur/16808ff138>

⁵⁷ Iniciativa Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar, Indeksi Global për Krimin e Organizuar 2021: <https://ocindex.net/country/albania>

⁵⁸ Report TV, Lufta ndaj krimin të organizuar, Kraja: Në 2021 sekuestruam 200 mijë m2 tokë në Gjirin e Lalzit: <https://www.youtube.com/watch?v=nj7773LWVp8>

⁵⁹ Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK), Raporti i Aktivitetit për Vitin 2021: <https://aapsk.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/Raporti-i-vitit-2021.pdf>
Raporti i Aktivitetit për Vitin 2020: <https://aapsk.gov.al/wp-content/uploads/2021/06/AAPSK-Raporti-Vjetor-2020.pdf>

⁶⁰ Akt Normativ Nr. 1, datë 31.1.2020 "Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimin të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike": https://qbz.gov.al/share/GYhmw3TqSkSQGZuyUhbC_w

në kuadër të zbatimit të këtij Akti është mjaft e ulët përkundrejt numrit të sekuestrimeve (26 konfiskime nga 255 sekuestrime).⁶¹

Megjithëse Raporti i Komisionit Evropian i vitit 2021 thekson se me krijimin e SPAK sekuestrimet dhe konfiskimet e aseteve kriminale janë kryer në mënyrë më koherente, rezultojnë një numër shumë i ulët i pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara të cilat rezultojnë nga kryerja e veprave penale që lidhen me korrupsionin dhe pastrimin e parave.⁶² Pjesën më të madhe të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara e përbëjnë pasuri me prejardhje nga veprimtari të krimit të organizuar siç janë veprat penale në fushën e narkotikëve dhe organizatave kriminale.

Megjithëse siç u evidentua në seksionin paraardhës të këtij dokumenti politikash, SPAK dhe Gjykata e Posaçme vendosën për konfiskimin e pasurive gjatë vitit 2021 të ish-Prokurorit të Përgjithshëm si edhe dy ish-anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe 1 ish-anëtari të Gjykatës së Lartë, numri i përgjithshëm i sekuestrimeve dhe konfiskimeve të funksionarëve apo ish-funksionarëve të niveleve të larta gjatë vitit 2021 ka qenë i ulët.



Nga ana tjetër, krijimi i Zyrës për Rikuperimin e Aseteve mbetet një prioritet për tu finalizuar deri në vitin 2023.⁶³ Shqipëria nuk ka një qasje strategjike apo sistematike për identifikimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale të cilat ndodhen jashtë vendit apo të cilat nuk janë të arritshme. Përveç mjeteve për ngrirjen, menaxhimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale sipas ligjit antimafia, Shqipëria duhet të miratojë dhe zbatojë rregullat për konfiskimin e zgjeruar dhe ngrirjen paraprake të aseteve. Gjithashtu Shqipëria duhet të përmirësojë urgjentisht kapacitetin e saj për të menaxhuar asetet e ngrira ose të konfiskuara në mënyrë që ato të mos humbasin vlerën e tyre.⁶⁴

⁶¹ Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK), Raporti i Aktivitetit për Vitin 2021: <https://aapsk.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/Raporti-i-vitit-2021.pdf>

⁶² Po aty

⁶³ VKM 516, datë 1.7.2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 247, datë 20.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2020” dhe miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023 e të Pasaportës së Indikatorëve”: https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/1.-PLANI-I-VEPRIMIT-ANTIKORRUPSION-2020-2023_AL.pdf

⁶⁴ Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2021: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en



Grafik 4: Numri dhe vlera e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara (2019-2021)

Burimi i të dhënave: Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara

2.3.4. Zhvillimet, tendencat dhe kërcënimet e krimit të organizuar

Krijimi, organizimi ose drejtimi i një grupi të strukturuar kriminal për kryerjen e veprave penale, pjesëmarrja në grupin e strukturuar kriminal dhe kryerja e veprave penale nga pjesëtarë të organizatës kriminale dhe të grupit të strukturuar kriminal janë veprat kryesore penale në **kuadër të organizatave kriminale**, të cilat evidentohen në procedimet në fushën e krimit të organizuar.

Veprat penale në **fushën e narkotikëve** përbëjnë gjithashtu akuzat kryesore në çështjet e krimit të organizuar, ndërkohë që vrasjet, mbajtja e paligjshme e armëve/municionit dhe kalimi në mënyrë të paligjshme të kufirit mbeten mënyrat kryesore të veprimit të grupeve të krimit të organizuar.

Duke qenë se krimi i organizuar paraqet tendenca dhe zhvillime dinamike, përveç njohurive mbi grupet dhe veprimtaritë kriminale, marrja e njohurive mbi vlerën e **përgjithshme të tregut të krimit të organizuar dhe nivelin e infiltrimit në biznese të ligjshme** nga grupet e krimit të organizuar përbën një tregues kryesor për të matur efektivitetin e luftës kundër krimit të organizuar.

PJESA III: Rekomandime

Duke qenë se lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është një nga sfidat dhe prioritetet kryesore të Shqipërisë në ecurinë e procesit të integritetit evropian, vlerësimi i rezultateve në këtë drejtim ka nevojë të bazohet në një metodologji të mirëpërcaktuar për mbledhjen e të dhënave si edhe raportimin e vetë institucioneve, transparencës dhe informimit në tërësi.

Megjithëse me mangësi të theksuara në drejtim të stafit teknik dhe administrativ, organet e reja kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar kanë patur një ecuri pozitive në lidhje me aspekte të caktuara që lidhen me transparencën dhe informimin e publikut, të cilat përfshijnë:

- Përditësimin sistematik të informacionit.
- Shkëmbimin në kohë dhe cilësi të informacioneve dhe të dhënave të kërkuara.
- Publikimin e Raporteve Vjetore
- Përmirësimin e programeve të transparencës dhe publikimin e të dhënave
- Përmirësimin e rubrikave të cilat lidhen me njoftimet dhe komunikime të caktuar me qëllim informimin e publikut dhe me gjerë.

Megjithatë, nevoja për të krijuar një metodologji të mirëhartuar për të matur dhe vlerësuar performancën sipas një analize cilësore bazuar në të dhëna të harmonizuara dhe konsoliduara mbetet një rekomandim kryesor për përmbushjen e të cilit ka ende nevojë për përmirësim.

Kjo me qëllim kryerjen e një vlerësimi sa më të plotë të performancës së institucioneve të hetimit dhe gjyqimit të veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, me qëllim përmirësimin e praktikave të raportimit nga këto institucione.

Gjithashtu përmirësimi i monitorimit, vlerësimin dhe transparencës mbetet i rëndësishëm për të identifikuar dhe analizuar efektivitetin e zbatimit të kompetencave, si dhe për të nxitur masa të duhura dhe të zbatueshme për adresimin e problematikave të hasura nga ky vlerësim.

Bazuar në gjetjet e gjeneuruara nga dokumenti i politikave, disa rekomandime që mund të kontribuojnë gjatë periudhës në vijim lidhen me:

- A. Përmirësimin e aksesit në të dhënat e Gjykatës nëpërmjet publikimit të vendimeve respektive.
- B. Kategorizimit dhe detajimit të informacionit dhe të dhënave sipas çështjeve të korrupsionit dhe krimit të organizuar.
- C. Standardizimit të të dhënave të Gjykatave të Posaçme me qëllim ndjekjen e ecurisë së çështjeve në shkallë të ndryshme.
- D. Publikimin në një seksion të dedikuar i të dhënave që lidhen me gjykimin e çështjeve gjatë viteve të mëparshme.
- E. Publikimin e Raporteve Vjetore mbi aktivitetin e institucioneve.

Scorecard 1 - Çështje të Korrupsionit (të reja 2021 & stoku 2020)

| PRODUKTIVITETI | | EFIÇENCA | | | | | RELEVANCA | | | | | | | | |
|---------------------|------------|---------------------------------|----------|----------|-----------|----------|---|---|--|--|---|---------------------|--|--|--|
| Statusi i Çështjeve | | Kohëzgjatja e procesit gjyqësor | | | | | Statusi i subjekteve të akuzuar/dënuar ose të përfshirë | | | | Niveli i pasojës që rezultojn nga sjellja kriminale | | | | |
| Nr. i çështjes | Përfunduar | Në gjykim | < 1 muaj | 1-6 muaj | 7-12 muaj | 1-2 vjet | > 2 vjet | Funksionarë të lartë shtetërorë ose të zgjedhur vendorë | Gjyqtarë, prokurorë dhe funksionarë të tjerë të drejtësisë | Persona që ushtrojnë funksione publike | Të tjerë/Qytetarë | Nr. i të pandehurve | Vlera ekonomike (humbja) më shumë se 1 milion Euro | Vlera ekonomike (humbja) ndërmjet 400 mijë Euro dhe 1 milion Euro. | Vlera ekonomike (humbja) ndërmjet 100 deri 400 mijë Euro |
| 1. | X | | | X | | | | | | X | | 1 | | | |
| 2. | X | | | | | | | | | X | | 1 | | | |
| 3. | X | | X | | | | | | | X | | 1 | | | |
| 6. | X | | | | | | | | | X | | 3 | | | |
| 7. | X | | | | X | | | | | X | | 2 | | | |
| 9. | X | | | | | | | | | X | | 1 | | | |
| 12. | X | | | | X | | | | | X | | 1 | | | |
| 13. | X | | | X | | | | | | X | | 1 | | | |
| 16. | X | | | | | | | | | X | | 3 | | | |
| 17. | X | | | | | | | | | X | | 2 | | | |
| 18. | X | | | | X | | | | | X | | 2 | | | |
| 20. | X | | | | | | | | | X | | 1 | | | |
| 21. | X | | | | X | | | | | X | | 2 | | | |
| 23. | X | | | | X | | | X | | | | 1 | | | |
| 24. | X | | | | | | | | | X | | 19 | | | |
| 25. | X | | | | | | | | | X | | 2 | | | |
| 26. | X | | | X | | | | | | X | | 1 | | | |
| 29. | X | | | X | | | | | | X | | 1 | | | |
| 30. | X | | | | | | | | | X | | 3 | | | |
| 31. | | X | | | | | | | | X | | 3 | | | |
| 34. | | X | | | | | | | | X | | 7 | | | |
| 35. | X | | | | X | | | | | X | | 1 | | | |
| 38. | | X | | | | | | | X | | | 1 | | | X |
| 39. | X | | | | | | | | | X | | 1 | | | |
| 40. | X | | | | | | | | | X | | 4 | | | |
| 41. | X | | | X | | | | X | | | | 1 | | | X |
| 42. | X | | | | | | | | | X | | 1 | | | |
| 43. | | X | | | | | | | | X | | 1 | | | |
| 46. | X | | | X | | | | | | X | | 1 | | | |
| 48. | X | | | | | | | | | X | | 1 | | | |
| 50. | | X | | | | | | | | X | | 3 | | | |
| 51. | X | | | | X | | | | | X | | 1 | | | |
| 52. | X | | | | X | | | | | X | | 1 | | | |
| 53. | X | | | | X | | | | | X | | 1 | | | |
| 55. | X | | | | X | | | | | X | | 2 | | | |
| 56. | X | | | | X | | | | | X | | 6 | | | |

| | | | | | | | | | | | | | | |
|-----|---|---|--|---|---|---|---|--|---|---|---|---|--|---|
| 57. | | X | | | | | | | X | | 1 | | | |
| 59. | | X | | | | | | | X | | 3 | | | X |
| 60. | | X | | | | | | | X | | 1 | | | X |
| 64. | X | | | X | | | | | X | | 1 | | | |
| 67. | X | | | | X | | | | X | | 3 | | | X |
| 70. | | X | | | | | X | | | | 6 | | | X |
| 77. | X | | | X | | | | | X | | 2 | | | |
| 79. | X | | | | X | | | | X | | 9 | X | | |
| 87. | X | | | X | | | | | X | | 1 | | | |
| 91. | | X | | | | | | | X | | 2 | | | |
| 92. | | X | | | | | | | X | | 1 | | | |
| 93. | | X | | | | | | | X | | 2 | | | |
| 40. | X | | | | | X | | | | X | 2 | | | |
| 46. | X | | | | | | | | X | | 1 | | | |
| 53. | X | | | | X | | | | X | X | 3 | | | |
| 61. | X | | | | X | | | | | X | 1 | | | |
| 65. | X | | | | X | | | | X | | 2 | | | |
| 68. | X | | | | X | | | | X | | 7 | | | |
| 71. | | X | | | | | | | | | 2 | | | |
| 81. | X | | | | | | | | X | | 1 | | | |
| 84. | X | | | | X | | | | X | | 2 | | | |
| 86. | X | | | | X | | X | | | | 2 | | | |
| 87. | X | | | | | | | | X | | 2 | | | |
| 89. | X | | | | X | | | | X | | 2 | | | |
| 90. | X | | | | X | | | | | | 1 | | | |
| 91. | X | | | X | | | | | | X | 1 | | | |
| 92. | X | | | X | | | | | | X | 1 | | | |
| 93. | X | | | | X | | | | | X | 1 | | | |
| 94. | X | | | X | | | | | | X | 1 | | | |
| 95. | X | | | | | X | | | | X | 1 | | | |
| 96. | X | | | | X | | | | | X | 1 | | | |

Burimi i të dhënave: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar & Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK)

Scorecard 2 - Çështje të Krimit të Organizuar (të reja 2021 stoku 2020)

| PRODUKTIVITETI | | EFIÇENCA | | | | | RELEVANCA | | | | | | | | | | | | | |
|---------------------|------------|---------------------------------|----------|----------|-----------|----------|------------------------|------------------------|-----|------|--|--|--------|---|---|--|---|------------------------------------|---------|--------|
| Statusi i Çështjeve | | Kohëzgjatja e procesit gjyqësor | | | | | Kompleksiteti i krimit | | | | | Niveli i pasojës që rezulton nga sjellja kriminale | | | | | | | | |
| Nr. i çështjes | Përfunduar | Në gjykim | < 1 muaj | 1-6 muaj | 7-12 muaj | 1-2 vjet | > 2 vjet | Veprat kryesore penale | | | Zona gjeografike e veprimit (veprimtari transnacionale e krimit të organizuar) | | | Vlera e mallrave të ligjshëm dhe/ose të paligjshëm të përfshirë | Veprimtaria/veprimet themelore kriminale të ndërmarra | | | Mënyra e veprimit (modus operandi) | | |
| | | | | | | | | Narkotikët | 3-5 | 5-10 | > 10 | AL + 1 | AL + 2 | | AL + > 2 | Pastrimi i produkteve të veprës penale | Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve | Falsifikimi | Vjedhja | Vrasja |
| 10. | X | | | | | | | X | | 1 | | | | | | | | | | |
| 11. | | X | | | | | | | | 1 | | | | | | X | | | | |
| 14. | X | | | | | | | | | 1 | | | | | | | | X | | |
| 15. | X | | | | | | | X | | 3 | | | | | | | | | | |
| 19. | X | | | | | | | X | | 1 | | | | | | | | | | |
| 28. | | X | | | | | | | | 2 | | | | | | | | X | X | |
| 32. | | X | | | | | | | | 12 | | | | | | X | | | | |
| 33. | X | | | | | | | X | | 2 | | | | | | | | | | |
| 36. | | X | | | | | | X | | 2 | | | | | | | | | | |
| 37. | | X | | | | | | X | | 2 | | | | | | | | | | |
| 44. | | X | | | | | | | | 2 | | | | | | | | | | X |
| 45. | | X | | | | | | X | | 1 | | | | | | | | | | |
| 63. | | X | | | | | | X | | 1 | | | | | | | | | | |
| 65. | | X | | | | | | | | 4 | | | | | | | | | X | X |
| 66. | | X | | | | | | | | 3 | | | | | | | | | X | X |
| 71. | | X | | | | | | X | | 2 | | | | | | | | | X | X |
| 73. | | X | | | | | | | | 4 | | | | | | | | | X | X |
| 74. | | X | | | | | | | | 21 | | | | | | X | | | | |
| 82. | | X | | | | | | X | | 23 | | | | | | X | | | | |
| 2. | X | | | | | | X | X | | 1 | | | | | | | | | | |
| 3. | X | | | | | | X | X | | 1 | | | | | | | | | | |
| 7. | X | | | | | | | | | 1 | | | | | | | | X | | |
| 12. | | X | | | | | | | | 1 | | | | | | | | | X | |
| 17. | | X | | | | | | X | | 2 | | | | | | | | | X | |
| 20. | X | | | | | | X | X | | 8 | | | | | | | | | | |
| 21. | | X | | | | | | | | 16 | | | | | | | | X | | |
| 22. | X | | | | | | | X | | 3 | | | | | | | | | | |
| 26. | X | | | | | | | X | | 4 | | | | | | | | | | |
| 28. | X | | | | | | X | | | 14 | | | | X | | X | | | | X |
| 34. | X | | | | X | | | | | 17 | | | | | | X | | | | |
| 37. | | X | | | | | | X | | 4 | | | | | | | | | | |
| 38. | X | | | | X | | | X | | 24 | | | | | X | | | | | |

⁶⁵ Veprat penale në kuadër të organizatave kriminale përfshijnë akuzat penale të parashikuara në: Neni 28/4; Neni 284/a; Neni 333; Neni 333/1; Neni 333/2; Neni 333/a; Neni 333/a/1; Neni 333/a/2; Neni 334; Neni 334/1 dhe Neni 334/2.

| | | | | | | | | | | | | | | | | |
|-----|---|---|---|---|--|--|---|----|--|--|---|---|---|---|---|---|
| 41. | | X | | | | | | 1 | | | | | X | | | |
| 42. | X | | | X | | | | 4 | | | | | | X | | |
| 43. | | X | | | | | | 2 | | | | X | | | | |
| 45. | X | | | | | | | 2 | | | | X | X | | | |
| 47. | X | | | X | | | X | 14 | | | | | | | | |
| 48. | X | | | X | | | X | 6 | | | | | | | | |
| 54. | X | | | | | | X | 1 | | | | | | | | |
| 60. | X | | | X | | | X | 21 | | | | | | | | |
| 63. | | X | | | | | | 1 | | | | | | X | | X |
| 64. | | X | | | | | X | 30 | | | | | | | | |
| 67. | X | | | | | | X | | | | | | | | | |
| 69. | X | | | | | | X | 1 | | | | | | X | | X |
| 70. | | X | | | | | X | 5 | | | | | | | | X |
| 72. | | X | | | | | | 8 | | | | | | X | | X |
| 73. | X | | X | | | | | 2 | | | X | | | | | |
| 76. | | X | | | | | | 3 | | | | | | | X | X |
| 77. | | X | | | | | | 1 | | | | | | X | | |
| 80. | | X | | | | | X | 4 | | | | | | | | |
| 83. | | X | | | | | | 1 | | | | | | X | | X |
| 85. | | X | | | | | X | 7 | | | | | | | | |
| 88. | | X | | | | | | 1 | | | | | | | X | X |

Burimi i të dhënave: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar & Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK)

Aneks 1: Të dhënat për 23 ish-gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të shkarkuar nga procesi i rivlerësimit (vetting) apo dorëhequr, të cilët po heton nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK)

| Nr. | Subjektet | Pozicioni | KPK | KPA | Arsyeja shkarkimit | SPAK | GJKKO (Shkalla I) |
|-----|-------------------|---|--|---|--|-------------------------------|--|
| 1. | Adriatik Llalla | Ish-Prokuror i Përgjithshëm | Ndërprerjen e procesit të rivlerësimit | Ndërprerjen e procesit të rivlerësimit/15 vite përjashtuar nga sistemi drejtësisë | Dorëhequr | Dërguar për gjykim Sekuestrim | Konfiskim/2 vite burg/5 vite përjashtim nga funksionet publike |
| 2. | Bashkim Dedja | Ish-kryetar i Gjykatës Kushtetuese | Konfirmuar | Shkarkuar | Kriteri pasurisë | Sekuestrim Dërguar për gjykim | Pranuar Kthyer |
| 3. | Fatos Lulo | Ish-gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese | Shkarkuar | Lënien në fuqi të Vendimit të KPK | Kriteri pasurisë | Sekuestrim Dërguar për gjykim | Pranuar Kthyer |
| 4. | Besnik Imeraj | Ish-gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese | Ndërprerjen e procesit të rivlerësimit | N/A | Dorëhequr | Pushon procedimin penal | |
| 5. | Gani Dizdari | Ish-gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese | Shkarkuar | Lënien në fuqi të Vendimit të KPK | Kriteri i pasurisë Kriteri i figurës | Pushon procedimin penal | Proces |
| 6. | Shkëlzen Selimi | Ish- gjyqtar në Gjykatën e Lartë | Shkarkuar | Lënien në fuqi të Vendimit të KPK | Kriteri i figurës | Sekuestrim Proces | Pranuar (50%) |
| 7. | Admir Thanza | Ish- gjyqtar në Gjykatën e Lartë | Shkarkuar | Lënien në fuqi të Vendimit të KPK | Kriteri i pasurisë Kriteri i figurës Kriteri profesional | Proces | |
| 8. | Tom Ndreca | Ish- gjyqtar në Gjykatën e Lartë | Shkarkuar | Lënien në fuqi të Vendimit të KPK | Kriteri i pasurisë Kriteri i figurës | Pushon procedimin penal | Proces |
| 9. | Edmond Islamaj | Ish- gjyqtar në Gjykatën e Lartë | Konfirmuar | Shkarkuar | Kriteri i pasurisë | Pushon procedimin penal | Proces |
| 10. | Aleksandër Muskaj | Ish- gjyqtar në Gjykatën e Lartë | Ndërprerjen e procesit të rivlerësimit/Përjashtimin nga sistemi i drejtësisë për një periudhë 15 vjeçare | Lënien në fuqi të Vendimit të KPK | Dorëhequr | Pushon procedimin penal | Proces |
| 11. | Guxim Zenelaj | Ish- gjyqtare në Gjykatën e Lartë | Ndërprerjen e procesit të rivlerësimit/Përjashtimin nga sistemi i drejtësisë për një periudhë 15 vjeçare | N/A | Dorëhequr | Proces | |
| 12. | Xhezair Zaganjori | Ish-gjyqtar/kryetar në Gjykatën e Lartë | Konfirmuar | Shkarkuar | Kriteri i pasurisë | Pushon procedimin penal | Proces |
| 13. | Artan Zeneli | Ish- gjyqtar në Gjykatën e Lartë | Shkarkuar | Lënien në fuqi të Vendimit të KPK | Kriteri i pasurisë Kriteri i figurës | Pushon procedimin penal | Proces |
| 14. | Fatmir Hoxha | Ish-gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese | Shkarkuar | Lënien në fuqi të Vendimit të KPK | Kriteri i pasurisë | | |
| 15. | Altina Xhoxhaj | Ish-gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese | Shkarkuar | Lënien në fuqi të Vendimit të KPK | Kriteri i pasurisë Kriteri profesional | | |
| 16. | Artan Broci | Ish- gjyqtar në Gjykatën e Lartë | Shkarkuar | Lënien në fuqi të Vendimit të KPK | Kriteri i pasurisë Kriteri profesional | | |
| 17. | Mirela Fana | Ish- gjyqtare në Gjykatën e Lartë | Pushimin e procesit të rivlerësimit | Procesi i rivlerësimit pushuar/15 vite përjashtuar nga sistemi drejtësisë | Dorëhequr | | |
| 18. | Andi Çeliku | Ish- gjyqtar në Gjykatën e Lartë | Ndërprerjen e procesit të rivlerësimit/Përjashtimin nga sistemi i drejtësisë për një periudhë 15 vjeçare | N/A | Dorëhequr | | |
| 19. | Evelina Qirjako | Ish- gjyqtare në Gjykatën e Lartë | Ndërprerjen e procesit të rivlerësimit/Përjashtimin nga sistemi i drejtësisë për një periudhë 15 vjeçare | Lënien në fuqi të Vendimit të KPK | Dorëhequr | | |
| 20. | Arjana Fullani | Ish- gjyqtare në Gjykatën e Lartë | Ndërprerjen e procesit të rivlerësimit/Përjashtimin nga sistemi i drejtësisë për një periudhë 15 vjeçare | Lënien në fuqi të Vendimit të KPK | Dorëhequr | | |
| 21. | Sokol Berberi | Ish-gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese | N/A | N/A | Dorëhequr | | |
| 22. | Vladimir Kristo | Ish-gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese | N/A | N/A | Dorëhequr | | |
| 23. | Majlinda Andrea | Ish- gjyqtare në Gjykatën e Lartë | N/A | N/A | Korrupsion | PP: Kërkesë për gjykim | GJL: Dënuar 4 vjet burg (pezulluar me 3 vjet shërbim prove)/5 vite përjashtim nga funksionet publike |

Burimi i të dhënave: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK), Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) dhe Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK)

Aneks 2: Rekomandimet në lidhje me nivelin e përgatitjes dhe përparimit të Shqipërisë në luftën kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (2020-2021)

| | |
|---|---------------------------------|
| 0 | Fillestar |
| 1 | Fillestar/disi (njëfarë niveli) |
| 2 | Disi (njëfarë niveli) |
| 3 | Disi (njëfarë niveli)/moderuar |
| 4 | Moderuar |
| 5 | Moderuar/i mirë |
| 6 | I mirë |

| | |
|---|---------------------|
| 0 | Regres |
| 1 | Asnjë përparim |
| 2 | Përparim i kufizuar |
| 3 | Pak përparim |
| 4 | Përparim i mirë |

| Viti | Përgatitja | Përparimi | Korrupsion | Përgatitja | Përparimi | Krim i Organizuar |
|------|-----------------------------|-----------------|--|-----------------------------|-----------------|---|
| 2021 | Njëfarë niveli përgatitjeje | Pak përparim | <ul style="list-style-type: none"> të vazhdojë të forcojë luftën kundër korrupsionit; progres i mëtejshëm drejt krijimit të një historie solide të hetimeve, ndjekjes penale dhe gjyqimit të rasteve të korrupsionit, sekuestrimit dhe konfiskimit/rikthyerjen e aseteve kriminale që rezultojnë nga veprat e lidhura me korrupsionin; të sigurojë që struktura e Posaçme për Antikorrupsionin dhe Krimin e Organizuar (SPAK), d.m.th. Prokuroria e Posaçme (PP) dhe Byroja Kombëtare e Hetimit (BKB), si dhe Gjykatat e SPAK, të trajtojnë efektivisht korrupsionin e nivelit të lartë; të sigurojë burime, aftësi dhe bashkëpunim adekuat ndërmjet këtyre strukturave të reja dhe subjekteve të tjera të ndjekjes penale dhe gjyqësore; të sigurojë që të nisin në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike procedurat penale kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve të akuzuar për sjellje kriminale gjatë procesit të rivlerësimit; të adresojnë në mënyrë efektive rekomandimet e GRECO-s dhe të zbatojë planin e veprimit përkatës brenda kornizës kohore. | Njëfarë niveli përgatitjeje | Përparim i mirë | <ul style="list-style-type: none"> të vazhdojë forcimin e luftës kundër krimin të organizuar, duke përfshirë bashkëpunimin me shtetet anëtare të BE-së, si dhe me agjencitë e BE-së, duke përfshirë EUROPOL-in dhe EUROJUST-in; numri i agjencive shqiptare të zbatimit të ligjit që kanë akses në SIENA duhet të zgjerohet më tej; të krijojë pa vonesë ose të caktojë një zyrë/agjenci për rikuperimin e aseteve në përputhje me acquis të BE-së që është përgjegjëse për identifikimin dhe gjurmimin e aseteve kriminale, siç parashikohet nga legjislacioni kombëtar; të forcojë reagimin efektiv të zbatimit të ligjit ndaj krimin kibernetik për të rritur zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale. |
| 2020 | Njëfarë niveli përgatitjeje | Përparim i mirë | <ul style="list-style-type: none"> vazhdojë të forcojë luftën kundër korrupsionit; të arrijë përparim të mëtejshëm drejt krijimit të një historiku të qëndrueshëm të çështjeve të korrupsionit, sekuestrimit dhe konfiskimit/rikuperimit të pasurive kriminale të rrjedhura nga veprat e lidhura me korrupsionin; të rrisë më tej përdorimin e hetimeve financiare; sigurojë që organet e specializuara antikorrupsion të krijuara së fundmi, të Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), d.m.th. Prokuroria e Posaçme (PP) dhe Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH), si dhe gjykatat kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar të bëhen funksionale dhe të trajtojnë në mënyrë efektive korrupsionin e nivelit të lartë; të sigurojë burime të përshtatshme dhe bashkëpunim midis këtyre strukturave të reja dhe me organet e tjera të prokurorisë dhe gjyqësorit; vazhdojë të përmirësojnë aksesin në regjistrat elektronikë kombëtarë për autoritetet e zbatimit të ligjit. | Njëfarë niveli përgatitjeje | Përparim i mirë | <ul style="list-style-type: none"> duhet të vazhdojë të forcojë luftën kundër krimin të organizuar, përfshirë përmes bashkëpunimit me shtetet anëtare të BE-së, si dhe EUROPOL-in; duhet të miratojë një strategji të re dhe një plan veprimi për drogën, të mbushë hendekun legjislativ për prekursorët e drogës dhe intensifikimin e luftës kundër trafikut të drogës; duhet të miratojë një strategji kundër krimin kibernetik dhe të krijojë një përgjigje më efektive të zbatimit të ligjit, e cila përqendrohet tek ndalimi, gjurmimi dhe ndjekja penale e kriminelëve kibernetikë dhe të trajtojë fenomenin në rritje të pornografisë së fëmijëve online. |